

**RAPORTI I ANALIZËS SË REZULTATEVE TË PYETËSORËVE TË
STUDENTËVE PËR VLERËSIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË
SË SHËRBIMEVE TË OFRUARA PREJ STAFIT NDIHMËS
AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV!
VITI AKADEMIK 2023-2024**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

**“SIGURIMI I CILËSISË NË UNIVERSITETIN “ISMAIL
QEMALI”, VLORË
PËRGJEGJËSI E PËRBASHKËT!”**

PUNUAN:

REZARTA SINANALIAJ

ROMINA TAHIRAJ

HARIKLA BEDULI

TETOR 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela e Përmbajtjes

I-	Hyrje	4
	<input type="checkbox"/> Kuadri Ligjor	5
	<input type="checkbox"/> Metodologjia	6
	<input type="checkbox"/> Pjesëmarrja	8
	<input type="checkbox"/> Kufizimet	12
II-	Rezultatet e Pyetësorit	13
	II.A- SEKSIONI I PARË	13
	<i>II.A.1- Sekretaritë mësimore</i>	13
	<i>II.A.2- Zyra e Shërbimit ndaj Studentit</i>	19
	<i>II.A.3- Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Aktiviteteve kulturore-sportive. (Alumni-studentë të diplomuar në vite në UV)</i>	24
	<i>II.A.4- Sektori i Bibliotekës Shkencore:</i>	29
	<i>II.A.6 - Sektori i IT-së:</i>	40
	<i>II.A.7- Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve Jashtë:</i>	43
	II.B-SEKSIONI I DYTË	47
	II.C-SEKSIONI I TRETË	52



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Lista e shkurtesave

- QKSH- Qendra e Kërkimeve Shkencore
- SPMJ- Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- VSA- Vendim Senati Akademik
- UV- Universiteti i Vlorës
- NJSBCVI – Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimit institucional
- UVMS – Sistemi elektronik i manaxhimit të informacionit të Universitetit

Bibliografia

¹ Statuti i Universitetit “ Ismail Qemali”, Vlorë. Neni 80. Fq. 46.

² Përfshirë këtu dhe Studentët që ndjekin Programin e Studimit Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

I- Hyrje

Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë i kushton një rëndësi të veçantë hartimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim vlerësimin dhe garantimin e ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare në Institucion¹. Një prej praktikave më të aplikuara me qëllim vlerësimin e aspekteve të veçanta në institucionet e arsimit të lartë dhe jo vetëm, është vjelja e opinionit dhe mendimit të studentëve. Vendosja e studentëve në qendër të proceseve të vlerësimit të politikave dhe aktivitetit të institucionit është jo vetëm një qasje parimore por njëkohësisht edhe një e drejtë e sanksionuar në Statutin e Universitetit të Vlorës, Neni 73, Pika d: “*Studentët kanë të drejtë të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në Universitet*”.

Në përmbushje të Standardit V.5 të Kodit të Cilësisë “*Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) përfshin dhe angazhon studentë në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.*” si dhe të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Masave për Përmbushjen e Rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit (Rekomandimi Nr.3), VSA nr. 29, datë 22.05.2018, Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë ka miratuar implementimin e ***Pyetësit të Studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të Ofruara prej Stafit Administrativ dhe Ndihmësakademik***, miratuara me VSA Nr. 51 datë 20.09.2019, ndryshuar me VSA Nr. 25, datë 12.05.2021. I cili është implementuar për herë të parë gjatë vitit akademik 2020-2021. Viti akademik 2023-2024 është viti i 4 (katërt) i implementimit të këtij pyetësi.

Pyetjet e të cilit janë të konceptuara në mënyrë të tillë që vjelin informacion në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e sektorit respektiv, duke mundësuar vjeljen e informacionit shumë dimensional për të hartuar më tej politika dhe identifikuar ato instrumenta të cilat do të përmirësojnë më tej.

¹ Statuti i Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë. Neni 80. Fq. 46.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Rezultatet e paraqitura në këtë raport sugjerohen të bëhen pjesë e analizave dhe të përfshihen në planet e veprimit dhe planet e punës me qëllim përmirësimin e mëtijshëm të shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Njëkohësisht rezultatet e paraqitura në raport ndihmojnë në vlerësimin mbi nivelin e përmbushjes së një sërë kriterëve dhe standardeve të Kodit të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë miratuar sipas prespektivës dhe vlerësimit të studentëve.

➤ *Kuadri Ligjor*

Hartimi i pyetësorit për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik është mbështetur në :

- ✓ Përcaktimet e Ligjit të Arsimit të Lartë nr.85/2015, datë 17.09.2015, Kreu IX, Neni 98, pika ç.
- ✓ Në standardet dhe Kriteret e Kodit të Cilësisë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Ky raport i referohet edhe standardeve dhe kriterëve për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme, të përcaktuara në VKM Nr.531, datë 11.9.2018.

Prej konceptimit të implementimit të një instrumenti të ri vlerësimi në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë deri në aplikimin e tij, janë prodhuar një sërë dokumenta të cilat vijnë në ndihmë të gjithë procesit:

- ✓ Urdhër i Rektorit nr. 31, datë 11.04.2019 "Për ngritjen e grupit të punës, për pilotimin e draft-pyetësorit të studentëve për vlerësimin e shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ/ ndihmës akademik në UV".
- ✓ Urdhër i Rektorit nr.31/1, datë 25.04.2019, "Për një ndryshim në Urdhërin Nr.31 datë 11.04.2019".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

- ✓ Vendimi i Senatit Akademik Nr.51, datë 20.09.2019 “Për Miratimin e Pyetësorit për Studentët për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të Ofruara Prej Stafit Administrativ dhe Ndihmësakademik në UV”.
- ✓ Vendim Senati Nr. 25, datë 12.05.2021 “Për një Ndryshim në Vendimin e Senatit Akademik Nr.51, datë 20.09.2019 “Për Miratimin e Pyetësorit për Studentët për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të Ofruara Prej Stafit Administrativ dhe Ndihmësakademik në UV”.
- ✓ Vendim i Senatit Akademik Nr. 26, datë 12.05.2021 “ Për disa Ndryshime në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 74 datë 16.06.2020 “ Për procedurën e Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve Prej Stafit Administrativ dhe Ndihmësakademik në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë”.
- ✓ Vendim i Senatit Akademik Nr. 74 datë 16.06.2020 “ Për procedurën e Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve prej stafit administrativ dhe ndihmësakademik në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë”.

KY RAPORT ËSHTË PËRPILUAR PREJ NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL, NGARKUAR JO VETËM PREJ VSA TË SIPËRCITUARA POR EDHE SI NJË DETYRË FUNKSIONALE PËRCAKTUAR NË STATUTIN E UV-SË, NENI 82.

➤ *Metodologjia*

Qasja metodologjike me qëllim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative në Universitetin “ Ismail Qemali”, Vlorë është sasiore dhe instrumenti për vjeljen e të dhënave është Pyetësi i Studentëve për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Shërbimeve të Ofruara prej Stafit Administrativ dhe Ndhimësakademik, miratuara me Vendim Senati Nr. 51 datë 20.09.2019, ndryshuar me Vendimin e Senatit Nr. 25, datë 12.05.2021.

Pyetësoni është i organizuar në katër seksione (pyetje kryesore) dhe është i përbërë prej 47 pyetjeve prej të cilave 38 janë të mbyllura si dhe 9 janë të hapura. Disa prej pyetjeve janë konceptuar të kushtëzuara nga përgjigjja e pyetjes së mëparshme si psh: në pyetjen P1.a mbi Sekretarinë mësimore, e vetëm nëse vlera e përgjigjes së studentëve për pyetjen “Sa shpesh e keni frekuentuar sekretarinë mësimore?” është : Gjithmonë, Shpeshherë, rrallëherë atëherë studentit i shfaqen pyetjet: 1.1. “A merrni përgjigje të qartë dhe të drejtëpërdrejtë për pyetjet që ju keni?”; 1.2 “A komunikon me ju sekretarja duke respektuar etikën e komunikimit?”. (Për më tepër referojuni draft-pyetësonit bashkëlidhur- Evidenca 6). Përgjigjet e pyetjeve të mbyllura janë të organizuara me 5 shkallë (Gjithmonë – Shpeshherë – Rrallëherë – Asnjëherë - Pa përgjigje / Mëse të Mjaftueshme - të Mjaftueshme - Aspak të Mjaftueshme – Nuk janë bashkëkohore - Pa Përgjigje/ Shumë të Mirë – të Mirë - Keq – Shumë keq - Pa përgjigje).

Seksioni i Parë, përkton me organizimin strukturor të stafit ndihmës akademik dhe administrativ të sektorëve dhe drejtorive, laboratorëve dhe qendrave kërkimore në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë më specifikisht: Sekretarinë Mësimore, Shërbimi ndaj Studentëve, Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Aktiviteteve kulturore-sportive, - Sektori i Bibliotekës Shkencore, Labororët/Qendrat Kërkimore Shkencore, pranë Fakulteteve, Shërbimet Teknologjike (IT), Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. (26 pyetje të mbyllura si dhe 8 pyetje të hapura).

Për secilin prej sektorëve përpos pyetjeve të mbyllura nëpërmjet një pyetje të hapur studentët shprehin opinionin e tyre mbi aspektet që dëshironin të përmirësonin. Njëkohësisht është e rëndësishme të theksohet se me qëllim vjeljen e një informacioni sa më objektiv, studentët të cilët nuk kishin marrë shërbim së paku një herë prej sektorit përkatës nuk mund të vlerësonin aspekte të tjera. Teknikisht është zgjidhur nëpërmjet pyetjeve kushtëzuese në **Google Forms**.

Në seksionin e dytë, të përbërë prej 6 pyetjeve të mbyllura dhe 1 të hapur, studentët kanë dhënë vlerësimin e tyre mbi infrastrukturën dhe kushtet higjienosanitare duke përfshirë disa dimensione



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

si mjediset e auditorëve, sistemin e ngrohjes, sistemin e ndriçimit, cilësinë e bazës materiale, higjiena e auditorëve, higjiena e tualeteve etj. Përseri studentët kanë të drejtë të zgjedhin midis 5 shkallëve: shumë mirë, mirë, keq, shumë keq, pa përgjigje.

Seksioni i tretë konsiston në 4 pyetje të mbyllura dhe ka për qëllim vjeljen e informacionit mbi përfshirjen e studentëve në aktivitete të ndryshme që organizon UV-ja si dhe identifikimin e instrumentave të preferuar prej studentëve për informim si facebook- Web, e-mail, sms etj.

Seksioni i katërt së fundi pyetëtori mbyllet me dy pyetje mbi të dhënat demografike: gjinia dhe cikli i studimit, të dhëna të cilat do të kenë një domethënie të veçantë gjatë procesit të analizimit të të dhënave.

➤ **Pjesëmarrja**

Sipas procedurës së Analizës së Pyetësorit të Studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga stafi administrativ dhe ndihmës akademik në Universitetin e Vlorës, e miratuar me VSA nr. 74, datë 16.06.2020 dhe e ndryshuar me VSA nr. 26, datë 12.05.2021, Sektori IT ka dërguar skedën e pyetësorit në formën e një linku Google Forms.

Metodologjia e Dërgimit të Pyetësorit

Linku për pyetësin është shpërndarë në llogaritë personale të studentëve në UVMS. Studentët kanë mundësinë të plotësojnë pyetësin nëpërmjet llogarive të tyre personale me domainin emër.mbiemër@univlora.edu.al. Kjo qasje e lehtëson pjesëmarrjen e studentëve dhe inkurajon angazhimin e tyre në vlerësimin e shërbimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Avantazhet e Përdorimit të Google Forms


Anonimitet dhe Privatësi: Përdorimi i Google Forms garanton anonimitet për studentët, duke i motivuar ata të japin mendime të sinqerta dhe të hapura.

Thjeshtësia e Përdorimit: Google Forms ofron një ndërfaqe të lehtë për t'u përdorur, duke bërë që procesi të jetë i aksesueshëm për të gjithë studentët.

Analizë e Shpejtë e Të Dhënave: Të dhënat e mbledhura mund të analizohen me efikasitet, duke mundësuar nxjerrjen e statistikave dhe konkluzioneve të nevojshme për përmirësimin e shërbimeve.

Kjo procedurë për analizën e pyetësorit është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në Universitetin e Vlorës. Duke inkurajuar studentët të shprehin mendimet e tyre në mënyrë anonime dhe të lehtë, ne jemi në gjendje të identifikojmë pikat e forta dhe dobësitë në shërbimet e ofruara, duke siguruar një ambjent akademik më të mirë për të gjithë. Kjo qasje tregon angazhimin e universitetit për të dëgjuar dhe përmirësuar përvojën e studentëve.

Grafiku 1: Pjesëmarrja e studentëve në pyetësor





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Në pyetësor morrën pjesë **492** studentë, një shifër në rritje kjo, krahasuar me vitin akademik 2022-2023, por përsëri 11.64% është një shifër e ulët dhe pse Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Insitucional (NJSBCVI) ka bërë fushata të shpeshta në të 4 (katër) Fakultetet respektive, në të gjitha programet e studimit të cilët kanë marrë të paktën 1 (një) shërbim në UV gjatë vitit akademik 2023-2024. Shpërndarja grafike si më poshtë vijon:

Tabela 1: Shpërndarja e pjesëmarrësve për çdo cikël studimi

Cikli i Studimit	Viti i Studimit	Nr i studentëve që kanë plotësuar pyetësorin	Shpërndarja e pyetësorëve në %
Cikli i Parë i Studimeve²	I	90	18.3%
	II	77	15.7%
	III	73	14.83%
Cikli i Dytë i Studimeve	I	142	28.86%
	II	108	21.95%
Cikli i Tretë i Studimeve	I-II	2	0.4%

Përqindja me e madhe e studentëve të cilët kanë plotësuar pyetësorin i përkasin Ciklit të Parë të Studimit. Ndërkohë që prej 3268 studentëve të regjistruar në Ciklin e Parë të Studimit për vitin akademik 2023-2024, përfshirë këtu dhe studentët që ndjekin programin e studimit Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi, si dhe Diplomë Profesionale, pyetësori është plotësuar prej 7.33% të studentëve. Përqindja e pjesëmarrjes së studentëve të regjistruar në Ciklin e Dytë të Studimit është 26.25%, si dhe 40% e studentëve të Ciklit të Tretë të studimeve kanë marrë pjesë në pyetësorë, së fundmi 11.64% e studentëve të regjistruar në UV për vitin akademik 2023-2024 kanë marrë pjesë në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përqindja e pjesëmarrjes së studentëve në raport me përqindjen e numrit të studentëve të regjistruar në ciklin dhe vitin e studimit respektiv.

² Përfshirë këtu dhe Studentët që ndjekin Programin e Studimit Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi dhe Diplomë Profesionale




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 2: Përqindja e Pjesëmarrjes së Studentëve në Pyetësor

<i>Cikli i Studimit</i>	<i>Viti i Studimit</i>	<i>% e pjesëmarrjes në Pyetësor</i>
<i>Cikli i Parë i Studimeve³</i>	I	2.75%
	II	2.35%
	III	2.23%
<i>Cikli i Dytë i Studimeve</i>	I	14.91%
	II	11.34%
<i>Cikli i Tretë i Studimeve</i>	I-II	40%

Përsa i përket shpërndarjes gjinore në pyetësor kanë marrë pjesë më shumë femra se sa meshkuj: **73.6%** femra dhe **26.4%** meshkuj, nga të cilët **362** janë femra dhe **130** meshkuj. Grafiku si më poshtë vijon, tregon shpërndarjen gjinore të pjesëmarrjes:

Grafiku 2: "Shpërndarja Gjinore e Pjesëmarrjes"



³ Përfshirë këtu edhe Studentët që ndjekin Programin e Studimit Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

➤ *Kufizimet*

Pjesëmarrja e studentëve në pyetësor të ndryshëm në institucionet e arsimit të lartë mbetet një prej sfidave më shpesh të hasura gjatë procesit të implementimit, veçanërisht kur kultura e cilësisë është ende në zhvillim. Shpesh, studentët nuk e kuptojnë rëndësinë dhe kontributin e anketave për përmirësimin e shërbimeve.

Megjithëse pyetëtori iu dërgua studentëve në llogarinë personale në UVMS, duke qenë se më tej ai u plotësua në formatin **Google Forms**, në rezultatet e pyetësorit mungojnë të dhënat mbi Njësinë Kryesore ku studentët ndjekin studimin. Sigurimi i një informacioni të tillë do të mundësonte analiza më të hollësishme brenda sektorëve përkatës për të evidentuar praktikatat e mira, me qëllim jo vetëm inkurajimin por edhe përmirësimin e mëtejshëm atje ku performanca është më pak e mirë.

Për kapërcimin e kufizimeve të mësipërme sugjerohen një sërë veprimtarish:

- ✓ Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në pyetësor sugjerohet ndërmarrja e fushatave informuese por njëkohësisht gjetja e mekanizmave kufizues sikurse aplikohen për pyetësorin e studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.
- ✓ Me qëllim identifikimin e njësisë kryesore të cilit i përkasin studentët, sugjerohet që pyetëtori të plotësohet në llogarinë personale në UVMS. Në pamundësi të krijimit të një platforme specifike në pyetësor sugjerohet që në seksionin e katërt të të dhënave demografike të shtohet edhe një pyetje mbi Njësinë Kryesore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

II- Rezultatet e Pyetësorit

Në vazhdim, për çdo seksion të pyetësorit që lidhet me sektorët dhe shërbimet e veçanta në Universitetin e Vlorës, janë paraqitur grafikisht rezultatet e pyetësorit, së bashku me përgjigjet dhe sugjerimet e studentëve në pyetjet e hapura për të përmirësuar shërbimin përkatës. Gjatë paraqitjes së rezultateve, është respektuar me rigorozitet etika e përpunimit të të dhënave, duke siguruar që të gjitha informacionet të ruhen në mënyrë konfidenciale. Anonimiteti i studentëve është mbajtur në çdo moment, duke garantuar që asnjë identitet nuk do të publikohet apo përdoret në analizat e bërë. Ky qasje jo vetëm që mbron të drejtën e studentëve për privatësi, por gjithashtu nxit një atmosferë besimi në procesin e vlerësimit të shërbimeve akademike dhe administrative.

Kjo analizë dhe këto rekomandime do të kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve në universitet, duke u bazuar në mendimet dhe sugjerimet e studentëve.

II.A- SEKSIONI I PARË


II.A.1- Sekretaritë mësimore

Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorës sekretaritë mësimore mund të cilësohen si një prej aktorëve më të rëndësishëm në marrëdhënien e institucionit me studentët gjatë gjithë jetës studentore prej fillimit deri në përfundim të ciklit të studimit. Pyetja e parë në seksionin e vlerësimit të shërbimeve të ofruara prej sekretarisë mësimore ka për qëllim jo vetëm identifikimin e shpeshtisë së përdorimit të këtij shërbimi por njëkohësisht mundëson që vetëm studentët të cilët kanë marrë këtë shërbim në UV të vijojnë më tej me vlerësimin e tij. 36.2% e studentëve janë shprehur se gjatë vitit akademik 2023-2024 e kanë frekuentuar gjithmonë sekretarinë mësimore, 35% shpeshherë, 24.2% rrallëherë, 2% asnjëherë, si dhe 2.6% e studentëve që kanë plotësuar pyetësorin e kanë lënë pa përgjigje. Grafiku 3 si vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 3: "Shpeshhtia e frekuentimit të Sekretarisë Mësimore gjatë vitit akademik 2023-2024"




Vetëm 3.3% e studentëve janë shprehur se nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje të qartë dhe të drejtpërdrejtë për pyetjet që i kanë drejtuar sekretarisë mësimore, ndërkohë që 12.6% janë përgjigjur rrallëherë.

Përqindja më e madhe e studentëve janë përgjigjur se gjithmonë kanë marrë përgjigje të qartë dhe të drejtpërdrejtë prej sekretarisë studentore 56.9% e tyre, si dhe 24.2% janë përgjigjur shpeshherë, si dhe 3% pa përgjigje.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 4: "Vlerësimi i studentëve mbi marrjen e përgjigjeve të qarta dhe të drejtpërdrejta për pyetjet drejtuar Sekretarisë mësimore"



Një tjetër aspekt për të cilin studentët kanë shprehur opinionin e tyre është respektimi i etikës së komunikimit prej stafit të Sekretarisë Mësimore. 63.4% e studentëve janë shprehur se gjithmonë është respektuar etika e komunikimit, në 21.1% të rasteve shpeshherë, për 7.3% të studentëve rrallëherë si dhe për 5.1% të studentëve asnjëherë dhe vetëm 3% e kanë lënë pa përgjigje.

Grafiku 5: "Vlerësimi i studentëve mbi respektimin e etikës së komunikimit prej Sekretarive Mësimore"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Së fundi në këtë seksion studentët nëpërmjet pyetjes së hapur kanë shprehur opinionin e tyre se çfarë do të dëshironin të përmirësonin. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të hollësishme të gjitha përgjigjet e studentëve. Duke qenë një pyetje fakultative **391** studentë i janë përgjigjur pyetjes së hapur prej të cilëve **158** janë shprehur se nuk do të dëshironin të ndryshonin asgjë në sektor duke vlerësuar mirëkuptimin, shërbimin, sqarimin etj.

Ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e studentëve do të dëshironin të ndryshonin një sërë aspektesh si mënyrën e komunikimit, etikën, sjelljen, vonesat dhe mosmarrjen e përgjigjeve, saktësinë e informacioni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 3: Komentet e studentëve- Sekretaritë Mësimore

Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (391 përgjigje)	
<i>Asgje (158 studentë)</i>	<i>Hallet dhe problemet personale te stafit te sekretarise nuk duhet te jene pjese e punes qe bejne dhe te ndikojne ne komunikimin qe kane me studentet!</i>
<i>Publikimi i orareve prapakisht, afishimi dhe informimi i studenteve ne menyre te rregullt periodike</i>	<i>Unë kam ngelur shumë e kënaqur. Nëse e krahasoj me para 10 vitesh kur kam qenë për herë të parë nuk ka të krahasuar me atë që është tani. Është super.</i>
<i>Ne pergjithesi kur kam patur dicka me jane pergjigjur (2 studentë)</i>	<i>Cdo gje eshte ne rregull, gjithmone gjej zgjidhje prane sekretareve te fakultetit ku studioj.</i>
<i>Te ishin me te gatshme te na ndihmoni</i>	<i>Të ndryshohet sekretarja. (5 studentë)</i>
<i>Te sqarojne</i>	<i>Noten (3 studentë)</i>
<i>N/A (3 studentë)</i>	<i>Cdo gje eshte ne rregull (9 studentë)</i>
<i>Nuk e di- Nuk kam (4 studentë)</i>	<i>Gjithcka eshtë mire (10 studentë)</i>
<i>Menyra e qasjes dhe komunikimit me studente, sepse mbi të gjitha paguhen për pune që ato duhet të bejnë</i>	<i>Me teper informacione rreth cdo gjëje lidhur me provimet oraret apo edhe rregjistrimet per secilin</i>
<i>Ok duket (3 studentë)</i>	<i>Organizimin e orareve mesimore (4 studentë)</i>
<i>Jo (3 studentë)</i>	<i>Te gjitha (3 studentë)</i>
<i>Cdo gje eshte super (2 studentë)</i>	<i>Mire - Shume mire (9 studentë)</i>
<i>Pergjigjen e sekretareve qe bertasin, nuk kane komunikim me ne fare</i>	<i>Kur krijojne inferioritet tek studenti dhe me shume bashkepunuese</i>
<i>Korrektesa ne pune etika ne komunikim (18 studentë)</i>	<i>Etiken ne komunikim dhe respektimi i orarit te punes. (8 studentë)</i>
<i>Nuk kam propozime/sugjerime (7 studentë)</i>	<i>Per momentin asgje (2 studentë)</i>
<i>Kerkesat qe ne bejme te plotesohen brenda afatit sepse ndonjehere shtyhen me teper se c'duhet.</i>	<i>Komunikimi me studente te realizohet permes e-mailit, te jene me te sakte dhe te pergjegjshem, te paanshem.</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Te na pergjigjet sekretaria sepse vijme nga rrethet dhe shpenzojme shume dhe nese smarim pergjigje atehere mbetemi mbrapa ne kohe</i>	<i>Te ishin me te informuara dhe te jepnin nje pergjigje te sakte.</i>
<i>Shpesh disa studente (jo une personalisht) kane patur probleme me logimin ne sistem per shkak te arsyeve te ndryshme. Nuk kane marre zgjidhje te menjehershme dhe ndoshta dhe sot nuk mund te logohen ne sistem per te pare vleresimet perfundimtare.</i>	<i>Te kete me shume lidhje nderinstitucionale ndermjet: Departamentit-Sekretarise-studenteve,me shume info,me shume bashkepunim etj:</i>
<i>Te behen perditesimet e informacionit, psh data provimesh ose cdo gje tjeter, nepermjet emaileve.</i>	<i>Qe pedagoget te lajmerojne nqs nuk zhvillojme seminarin ose leksionin</i>
<i>Te sqaroje me mire pyetjet tona dhe jo te pergjigjet mire sa here eshte me hene te mire</i>	<i>Sherbimi eshte shume korrekt dhe me miresjellje ne cdo ore .Nuk kam dicka per sugjerim .</i>
<i>Sekretarin ju lutem se jan lekiste ato sdo te thot mos na kthejn ne pergjigje ngelem duke u lutur cdo dite per nje pergjigje per burse na jan neveritur sa ska me .</i>	<i>Lenda e anglishtes qe e zhvilluam simestrin e par dhe 3 her gjithsej bem mesim</i>
<i>Te gjithë e bejne punen e tyre me perkushtim (2 studentë)</i>	<i>Te jene sa me te specifikuar per dokumente qe duhet te dorzojme</i>
<i>Permiresim ne pjesen e vonesave te dokumentave</i>	<i>Ndryshoni sekretaret se ngelen ne kafe</i>
<i>Sherbimi ndaj studenteve (6 studentë)</i>	<i>Nuk mendoj se ka ndonjë nevojë për përmirësim</i>
<i>Sherbimin online (2 studentë)</i>	<i>Cdo gje eshte sic e dua une</i>
<i>Jane shume korrekte dhe te perkushtura</i>	<i>Informaciont te jene me te shpejta</i>
<i>Per pyetje te përditshme do te ishte mirë nje touch screen</i>	<i>Mesimdhenia me interaktivitet (3 studentë)</i>
<i>Asnjë gjë cdo gjë është në rregull dhe shumë precize</i>	<i>Jeni shume te mire nuk do doja asgje te ndryshoja</i>
<i>Sekretaret te jene me te komunikueshme</i>	<i>Orarin e tyre ne pune (2 studentë)</i>
<i>Shpjegimi me videoprojektor</i>	<i>Çdo gjë ne nivelin e duhur</i>
<i>Te gjithë nxenesit te jene te barabarte</i>	<i>Asgje nuk dua te permiresoj (5 studentë)</i>
<i>Sa me shume komunikim me studentet (2 studentë)</i>	<i>Laboratoret</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Sherbimi eshte shume korrekt (2 studentë)</i>	<i>Praktikat</i>
<i>Orare te percaktuar te saj</i>	<i>Cdo gje me duket brenda normativave</i>
<i>Te ishin me te gatshme te na ndihmoni</i>	<i>Sherbimet mbeshtetese</i>
<i>Ne lidhje me sekretarine asgje</i>	<i>Sjelljen te sekretaria (4 studentë)</i>
<i>Kryesorja te jete prezente ne zyrë</i>	<i>Menyren e komunikimit dhe korrektesine</i>
<i>Te vazhdohet keshtu!</i>	<i>Nuk kam verejtje</i>
<i>Te jene me informues</i>	<i>Asgje ne vecanti</i>
<i>Dashamiresia</i>	<i>Infrastrukturen</i>
<i>Jemi të kënaqur</i>	<i>Zyshat te jen pak me te kuptueshme</i>
<i>Ndoshta pak permiresim</i>	<i>Pak gjera</i>
<i>Pastertine</i>	<i>Te jene njerez normal</i>


II.A.2- Zyra e Shërbimit ndaj Studentit

Si pjesë e integruar e Shërbimeve Studentore, në çdo njësi kryesore është atashuar Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve e cila është një urë lidhëse në ndërveprimin në mes pritjeve dhe nevojave institucionale të studentëve, duke kontribuar në përvojën e tyre të përgjithshme në UV. Nga sa më sipër studentët u pyetën mbi shpeshtinë e frekuentimit të zyrës gjatë vitit akademik 2023-2024. 25.8% e kanë frekuentuar gjithmonë zyrën e studentit, 28% shpeshherë, 26.2% rrallëherë. Njëkohësisht 13.8% e studentëve të cilët kanë plotësuar pyetësorin nuk e kanë frekuentuar asnjëherë zyrën, si dhe 6.1% e studentëve kanë zgjedhur alternativën pa përgjigje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 6: "Përqindja e Frekuentimit të Zyrës së Shërbimit ndaj Studentëve"




Dy pyetjet që vijojnë janë të fokusuara mbi respektimin e etikës së komunikimit dhe nëse përgjigjet e marra prej specialistëve përkatës kanë përmbushur pritshmëritë e studentëve, për të vjelur një informacion sa më pranë të vërtetës, pyetjeve kanë pasur mundësi t'u përgjigjen vetëm studentët të cilët kanë frekuentuar së paku një herë Zyrën e Shërbimit ndaj Studentëve gjatë vitit akademik 2023-2024.

Nëpërmjet pyetësorit studentët vlerësuan nëse kanë marrë përgjigje të qarta dhe të drejtpërdrejta për pyetjet që iu kanë drejtuar specialistëve të sektorit. Vetëm 4.5% janë përgjigjur asnjëherë dhe 9.1% rrallëherë ndërkohë që 49.4% e studentëve janë përgjigjur gjithmonë dhe 22.4% shpesh herë dhe vetëm 14.6% pa përgjigje. Për më tepër grafiku:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 7: "A merrni përgjigje të qartë dhe të drejtpërdrejtë për pyetjet që ju keni?"




Në lidhje me respektimin e etikës së komunikimit prej personelit 56.5% e studentëve janë përgjigjur gjithmonë, 18.5% shpeshherë, 6.5% respektivisht rrallëherë dhe vetëm 25 studentë pra vetëm 5.1% janë përgjigjur asnjëherë nga **492** prej tyre që ia janë përgjigjur, **66** studentë pra 13.4% janë pa përgjigje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 8: "Vlerësimi mbi respektimin e etikës së Komunikimit prej zyrës së studentëve"



Pyetjes së hapur: “Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit?” - i janë përgjigjur **372** studentë, më shumë se gjysma e studentëve pjesëmarrës në pyetësor, ku të cilët **170** studentë janë shprehur **Asgjë**. Duke iu referuar tabelës përmbledhëse për pyetësorin e organizuar mbi shërbimin e Zyrës së Studentëve rreth 45.7% e studentëve që i janë përgjigjur pyetjes së hapur janë shprehur se nuk do të dëshironin të ndryshonin asgjë ose të përmirësonin.

Edhe në këtë sektor një pjesë e studenëve janë shprehur se do të dëshironin të përmirësohej mënyra e komunikimit si dhe një pjesë edhe pse e vogël në numër janë shprehur mbi një orar më të përshtatshëm ose një orar fiks.



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 4: Komentet e studentëve- Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve

Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (372 përgjigje)	
<i>Asgje (170 studentë)</i>	<i>Nuk e di (6 studentë)</i>
<i>Prania e stafit te jete prezente,mungesat jane te shpeshta , rrallehere e gjejme te pranishme.</i>	<i>Eshte ne rregull (10 studentë)</i>
<i>Personeli i sherbimit ndaj studentit eshte ne rregull me gjithcka permbush ky pozicion</i>	<i>Tolerimin ne rast provimesh,sepse eshte e sigurt qe hutohemi nga ankthi dhe shpesh here harrojme ti shkrujame,(nuk na kujtohen).</i>
<i>Sektori I Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Aktivitetete kulturore-sportive.</i>	<i>Te jane te pranishme gjate gjithë orarit ne ambjentet e universitetit</i>
<i>Sic thashe edhe me larte, stafi duhet te jete me i komunikueshem me studentet per problemet dhe paqartesite qe ata kane.</i>	<i>Nuk eshte se me ka rene rasti te shkoj shpesh por mendoj se pergjigjen korrekte</i>
<i>Qe te kete mbledhje me studentet dhe te mund te flasin problemet e tyre</i>	<i>Do ishte mire qe sekretaria(et) te ishte me e bute ne komunikim.</i>
<i>Etiken ne te folur (2 studentë)</i>	<i>Pa pergjigje (3 studentë)</i>
<i>Çdo gjë në këtë institucion aq me pak në Fakultetin e infermierisë.</i>	<i>Te jene aty ne orarin e punes, jo ne kafe (4 studentë)</i>
<i>Nuk e kam pasur te nevojshme te vete te keto zyra (2 studentë)</i>	<i>Cilesine e sherbimit (2 studentë)</i>
<i>Noten (3 studentë)</i>	<i>Jane shume korrekte dhe te perkushtura</i>
<i>Te ishte ne detyre nje me e zonja se ajo sekretare</i>	<i>Ndryshim sekretaresh (2 studentë)</i>
<i>Orarin (5 studentë)</i>	<i>Nuk kam (4 studentë)</i>
<i>Te kishim nje shkolle te re</i>	<i>Mire - Shum mire (8 studentë)</i>
<i>Edhe ky shërbim ka notën 10</i>	<i>Te gjithë e bejne punen e tyre me perkushtim</i>
<i>Komunikim me te shpesht me studentet (10 studentë)</i>	<i>Aktivitetete te ndryshme ne kuader te deges se zgjedhur.</i>
<i>Disa gjera te vogla</i>	<i>Gjithcka eshte ok (6 studentë)</i>
<i>Te njoftohen studentet ne e-meile</i>	<i>Organizimin e orareve mesimore (2 studentë)</i>
<i>Jeni shum te mir nuk do doja asigje te ndryshoja</i>	<i>Nuk kam propozim (9 studentë)</i>
<i>Cdo gje perfekte (3 studentë)</i>	<i>Korrekesen ne oraret e punes</i>
<i>Skam ankesa /Skam koment/ Nuk kam verejtje</i>	<i>Te na japin informacionin e nevojshem (2 studentë)</i>
<i>Nuk kam pakenaqesira/ Nuk kam info.</i>	
<i>Te gjithë e bejne punen e tyre me perkushtim</i>	<i>Te vazhdohet keshtu!</i>
<i>Jemi te kenaqur me sherbimin</i>	<i>Laboraret</i>
<i>Shtimin e stafi</i>	<i>Jo (3 studentë)</i>
<i>Nuk ka asgje per te ndryshuar</i>	<i>Te gjitha (2 studentë)</i>
<i>Komunikim i vazhdueshem me personelin</i>	<i>Te jene te gatshem te ndihmojne</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Skam frekuentuar</i>	<i>Personeli ka etikë komunikimi.</i>
<i>Çdo gjë ne nivelin e duhur</i>	<i>Pak permiresim</i>
<i>Me shume shpjegime</i>	<i>Lenda e anglishtes</i>
<i>Praktiken</i>	<i>Me shume aktivitete</i>
<i>sherbimi</i>	<i>etika / orari ne pune</i>
<i>Sjelljen</i>	<i>Leksion</i>
<i>Zero</i>	<i>Dijet</i>

***II.A.3- Sektori i Këshillimit të Karrierës, ALUMNI dhe Aktiviteteve kulturore-sportive.
(Alumni- studentë të diplomuar në vite në UV)***


Me qëllim nxitjen e marrëdhënieve të ndërsjellta midis studentëve, Alumni-t, miqve të universitetit, kompanive në rajon, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Sektori i Këshillimit të Karrierës ALUMNI dhe Aktiviteteve Kulturore- Sportive, organizon aktivitete të ndryshme në mënyrë periodike si: panairi i karrierës, aktivitete sportive, intervista të stimuluar, maratonë etj. Për vitin akademik 2023-2024, shumë studentë janë përgjigjur se nuk kanë ndjekur asnjëherë aktivitet të organizuara prej sektorit. Ndërkohë që 27.8% e studentëve i janë përgjigjur gjithmonë, 21.5% shpeshherë dhe 19.5% rrallëherë, 20.1% asnjëherë dhe 11% pa përgjigje.

Grafiku 9: "Përqindja e pjesëmarrjes në aktivitet sportive, open day, panair i karrierës, intervista të stimuluar etj:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 9: “Përqindja e pjesëmarrjes në aktivitetet sportive, open day, panair i karrierës, intervista të stimuluar etj”




Studentët të cilët i janë përgjigjur pyetjes “A keni marrë pjesë në aktivitete (të tilla si: praktikë profesionale, open day, aktivitete sportive, panair i karrierës, intervista të simuluar, maratona etj.) të organizuara nga sektori për vitin akademik?” duke përzgjedhur një prej alternativave: gjithmonë, shpeshherë dhe rrallëherë kanë vlerësuar më tej këto aktivitete nga shkalla shumë mirë në shumë keq. 43.9% e studentë i kanë vlerësuar shumë mirë, dhe 29.7% mirë, 24.4% pa përgjigje, vetëm 1.2% keq dhe vetëm 4 studentë pra 0.8% shumë keq.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 10: "Vlerësimi i aktiviteteve të organizuara prej sektorit"



Në lidhje me respektimin e etikës së komunikimit prej personelit të sektorit, 50.4% e studentëve janë përgjigjur se është respektuar gjithmonë, 19.9% shpeshherë, vetëm 3% asnjëherë, si dhe 5.5% rrallëherë, 21.1% pa përgjigje, për më tepër referojuni grafikut nr. 11:

Grafiku 11: "Respektimi i Etikës së Komunikimit"






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Pyetja e fundit të mbyllur për sektorin: “A gjykoni se janë të mjaftueshëm aktivitetet e organizuara nga sektori?” ka për qëllim vlerësimin e nevojave të studentëve duke shërbyer për të ardhmen si pikë referimi për të përpiluar më tej planin e aktiviteteve. Për 33.1% të studentëve, aktivitetet ishin më se të mjaftueshme, për 23% të mjaftueshme, 18.9% dhe 5.3% studentëve respektivisht aktivitetet janë deri-diku dhe të pamjaftueshëm si dhe 19.7% e kanë përzgjedhur alternativën pa përgjigje, për më tepër grafiku i mëposhtëm:

Grafiku 12: "A janë të mjaftueshëm aktivitetet e organizuara prej sektorëve"



Në pyetjen e fundit të seksionit, studentët kanë dhënë një sërë propozimesh mbi aspektet që do të dëshironin të përmirësonin, të pasqyruara në Tabela 5: Komentet e studentëve- Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t. Nga **492** studentë që kanë marrë pjesë në pyetësor, për këtë pyetje të hapur janë përgjigjur **373** studentë. Disa prej studentëve shprehen se nuk ka nevojë për përmirësim dhe se çdo gjë është në rregull, specifikisht **155** studentë janë shprehur **asgjë**, disa të tjerë kanë nevojë për më shumë aktivitete dhe zhvillimet e këtyre aktiviteteve të kenë këndin e tyre dhe të jenë më gjithëpërfshirëse për studentët. Tabela 5 si vijon:



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 5: Komentet e studentëve- Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t

Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (373 përgjigje)	
<i>Asgje (155 studentë)</i>	<i>Komunikimin (2 studentë)</i>
<i>Tepër e kënaqur mendoj kush dëshiron të marrë extra informacion e ka pasur të mundur më së miri.</i>	<i>Nuk mjafton vetem deshira e pedagogëve dhe jona duhen palet e treta të kontribuojnë në aktivitete që të mund të jenë të arritura</i>
<i>Korrektesia nga ana e strukturës së transportit (Automjetit të transportit të Studentëve)</i>	<i>Nuk jemi të informuar a ekzistojnë këto aktivitete dhe alumni në universitetin tonë?!</i>
<i>Duhet të lajmërohen studentet më para për aktivitetet jo në momentin e fundit</i>	<i>Ne si studente nuk kemi asnjë informacion në lidhje me aktivitetet e zhvilluara në universitet.</i>
<i>Me shumë info në lidhje me të drejtat e studentëve, bashkëpunim, shoqërim në vendimet e tyre për të ardhmen</i>	<i>Aktivitetet duhet të jenë pjesë e kursit, në mënyrë që edhe studenti të arrijë të jetë me afër asaj që është duke studiuar, d.m.th të jetë pak a shumë si praktike. Mire do të ishte të kishte aktivitete çdo javë</i>
<i>Nuk kam sugjerime/Nuk kam përgjigje/Nuk kam propozim/nuk kam mendim/skam koment (19 studentë)</i>	<i>Me shumë aktivitete për të gjithë studentet (27 studentë)</i>
<i>Cilesine e shërbimit (3 studentë)</i>	<i>Cdo gjë është në rregull (8 studentë)</i>
<i>Te këto sa më shumë aktivitete të ndryshme. Pse jo dhe udhëtime mesimore.</i>	<i>Partneritet me universitete brenda dhe jashtë vendit.</i>
<i>Duhet të lajmërohen studentet më para për aktivitetet jo në momentin e fundit</i>	<i>Shpërndarje e informacionit, nëpërmjet teknologjive, rrjeteve sociale, por edhe fizikisht.</i>
<i>Sa më shumë aktivitete sportive</i>	<i>Aktivitete dhe praktika në biznese</i>
<i>Sa më shumë aktivitete kreative.</i>	<i>Nuk e di/ Nuk kam (16 studentë)</i>
<i>Te reklamohen dhe t'ju jepet vëmendja e duhur! Me shumë aktivitete kulturore dhe me gjithëpërfshirëse.</i>	<i>Përfshirjen e studentëve në aktivitete (2 studentë)</i>
<i>Aktivitete frytëdhënëse</i>	<i>Laboratorët (2 studentë)</i>
<i>Nuk kam marrë pjesë sepse jam në marrëdhënie pune</i>	<i>Me shumë mundësi për praktike profesionale</i>
<i>Jo (2 studentë)</i>	<i>Notën (3 studentë)</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Te ndiqnim sa me shume aktivitetet profesionale per tu permiresuar</i>	<i>Te kishim me shume informacione per aktivitetet te ndryshme (4 studentë)</i>
<i>Sensibilizimin</i>	<i>Gjithcka/Shum mire/mire (9 studentë)</i>
<i>Skam shkuar ndonje here</i>	<i>Ka vend per permirsim (4 studentë)</i>
<i>Praktika me te shpeshta (2 studentë)</i>	<i>Praktikat dhe sherbimi ndaj studentit te higen nga shkolla</i>
<i>Te ndihmojne</i>	<i>Çdo gjë ne nivelin e duhur</i>
<i>Perfshirje akoma edhe me shume te studenteve</i>	<i>Pak gjera</i>
<i>Nuk eshte e nevojshme</i>	<i>Më te shpeshta</i>
<i>Shum gjera</i>	<i>Nuk kam verejtje</i>
<i>Sherbimi ndaj studentit</i>	<i>Spektori i Bibliotekës Shkencore</i>
<i>Deri diku</i>	<i>Asgje konkrete</i>
<i>Zero</i>	<i>Vijon mirë</i>


II.A.4- Spektori i Bibliotekës Shkencore:

Spektori i Bibliotekës Shkencore në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë është një strukturë e rëndësishme në UV dhe ka për qëllim mbështetjen e procesit mësimor, për këtë arsye në institucion përpos bibliotekës qendrore janë funksionale edhe biblioteka pranë FSHTN dhe FSHHD. Në pyetjen e parë se sa shpesh i kanë frekuentuar Bibliotekat gjatë vitit akademik 2023-2024, 22.8% e studentëve janë përgjigjur gjithmonë, 19.9% shpeshherë, 19.9% rrallëherë, 27.4% e të anketuarve janë përgjigjur asnjëherë si dhe 10% pa përgjigje. Më poshtë janë paraqitur grafikisht përgjigjet e studentëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 13: " Sa shpesh i keni frekuentuar mjediset e Bibliotekës gjatë vitit akademik?"




Pyetjes së dytë nëse i plotëson literatura e bibliotekës nevojat e studentëve përqindja më e lartë e studentëve janë përgjigjur përgjithësisht po, 29.7% gjithmonë dhe vetëm 5.5% e studentëve është përgjigjur se nuk janë bashkëkohore, për 4.5 % aspak si dhe 31.5% e të anketuarve kanë përzgjedhur alternativën pa përgjigje. Grafiku si vijon:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 14 : "A i plotëson literatura e Bibliotekës nevojat tuaja?"



Rezultatet e pyetjes së tretë se a komunikon personeli duke respektuar etikën e komunikimit, 45.7% e studentëve janë përgjigjur gjithmonë, 17.1% shpeshherë, 5.7% rrallëherë, 28.7% pa përgjigje dhe vetëm 2.8% janë shprehur asnjëherë. Këto të dhëna janë të shpërndara sipas grafikut që vijon:

Grafiku 15: "A komunikon me ju personeli duke respektuar etikën?"






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Numri dhe përqindja më e lartë e të anketuarve e vlerësojnë mëse të mjaftueshëm, orarin e shërbimit të ofruar prej bibliotekës 35.2%, 23.4% të mjaftueshëm, 11.2% deri diku. Nga 492 studentë që ia janë përgjigjur kësaj pyetje vetëm për 12 studentë (2.4%) orari i ofrimit të shërbimit në bibliotekë është i pamjaftueshëm dhe 27.8% pa përgjigje. Grafiku 16 si më poshtë:

Grafiku 16: "A është i mjaftueshëm orari i shërbimit?"



Më tej studentët kanë propozuar se cili do të ishte orari më i përshtatshëm për të frekuentuar bibliotekën, duke u shprehur se orari më i përshtatshëm është prej 08⁰⁰-14⁰⁰, ose orari aktual. Por vlen të theksohet se kanë qenë të shumtë dhe studentët të cilët e janë shprehur *asgjë*, respektivisht **32** nga **348** pjesëmarrës në pyetësor. Tabela 6 e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 6: Komentet e studentëve- Biblioteka Shkencore dhe Orari

<i>Ju lutem propozoni orarin më të përshtatshëm për ju : nga ora: ____ deri në ____ (348 përgjigje)</i>			
Asgje (32 studentë)	12:00-09:00	S'kam frekuentuar (7 studentë)	08:00-15:00 (4 studentë)
12-2 (3 studentë)	8-2 (14 studentë)	9-1 (4 studentë)	Orari aktual (11 studentë)
09:00-12:00 (10 studentë)	15:00-18:00	10-11 (2 studentë)	12-4 (2 studentë)
08:00-18:00 (4 studentë)	S'kam përgjigje (19 studentë)	12-14	10-13 (4 studentë)
2-4 (9 studentë)	16 deri ne 18 (2 studentë)	10:00-16:00 (3 studentë)	9 deri ne 3 (3 studentë)
8/6	Ora 8 deri ne (19 studentë)	08-20 (7 studentë)	Nga ora 5 deri ne 7 (3 studentë)
Nga ora 09:00 deri ne 16:00 (5 studentë)	09:00-12:00 (8 studentë)	I mjaftueshem	9-12
Nga ora 8-15	8-17 (3 studentë)	8-13 (5 studentë)	09:00-20:00
Nga ora 9 deri ne 15:00	8-4 (19 studentë)	Pasdite	14-16 (2 studentë)
<i>Nuk e kam pare ndonjehere personelin e bibliotekes, nuk e joh fare. Sa here kam shkuar e kam gjetur zyren mbyllur (3 studentë)</i>			
14-18 (2 studentë)	16-19	13-18	8-15
10-1	8-12 (6 studentë)	2-4	9-14 (7 studentë)
<i>2 ore ne cdo jave/biblioteke e plot me literarute bashkekohore dhe rifreskim ne menyre periodike</i>			
11-12	11-15	5-6	12-3 (3 studentë)
10-14	2-8 (3 studentë)		
<i>Nuk me ka rene rasti I frekuentimit te bilitotekes deri tani. Ne te ardhmen shpresoj qe te me lidhi puna (2 studentë)</i>			
9-6	8-10 (2 studentë)	4-6	10-15 (2 studentë)
12:00-17:00	14-17	10-14 (5 studentë)	Varet nga nevojat e studenteve
12:00-3:00	15-17 (2 studentë)	10:00-18:00 (2 studentë)	7-3
5-9 (2 studentë)	11-2	13:00-17:00 (2 studentë)	8-21 (2 studentë)
9-13 (3 studentë)	5-9	10-12 (5 studentë)	14-15




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

16:00-20:00 (2 studentë)	6-8 (2 studentë)	6-7	8-15 (3 studentë)
14-17	10-12	Nuk kam sugjerime (3 studentë)	Pa përgjigje (3 studentë)
8-11	09:00-13:00 (2 studentë)	8-13	8-15

Pyetjes së tretë të këtij seksioni se sa shpesh e keni frekuentuar Bibliotekën online gjatë vitit akademik, 21.1% gjithmonë, 14.4% shpeshherë, 20.3% rrallëherë, 16.9% pa përgjigje dhe 27.2% janë shprehur asnjëherë. Me paraqitjen grafike si më poshtë vijon:

Grafiku 17: "Sa shpesh e keni frekuentuar Bibliotekën Online gjatë vitit akademik?"



Megjithëse një pjesë e konsiderueshme e studentëve në pyetjen e hapur janë shprehur se vlerësojnë mënyrën e komunikimit dhe nuk kishin asnjë propozim për ndryshim përsëri nuk mungojnë sugjerimet për aspekte të veçanta si : të ketë më shumë hapësirë për studentë brenda bibliotekës, pasi mendojnë se nuk është një hapësirë e mjaftueshme për të studiuar; të rinovohen ambientet e



REPubLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

sallës së bibliotekës, të pajisen me kompjutera, internet, fotokopje, të pajiset me literaturë bashkëkohore sipas departamenteve të ndryshëm të fakultetit etj... për më tepër referojuni tabelës së hollësishme:

Tabela 7: Komentet e studentëve- Biblioteka Shkencore

Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (352 përgjigje)	
<i>Asgje (156 studentë)</i>	<i>Se di (19 studentë)</i>
<i>Te kishte me shume shumellojshmeri pasi ka shume mungesa</i>	<i>Sa me shume materiale ne ndihme te studenteve ne te gjitha deget.</i>
<i>Laboratorët/Qëndrat Kërkimore Shkencore, pranë Fakulteteve (3 studentë)</i>	<i>Nuk kam sugjerime/Nuk kam mendim/Nuk kam propozim (8 studentë)</i>
<i>Shumellojshmeri literature (9 studentë)</i>	<i>Sa me shume artikuj shkencore.</i>
<i>Sistemin on line (4 studentë)</i>	<i>Eshte ne rregull/ Cdo gje mire/Gjithcka ok (27 studentë)</i>
<i>Te informohen me shume studentet dhe te gjenden menyra qasjeje me qellim qe te kalojne kohen e lire ne biblioteken e Universitetit</i>	<i>Propozimin e studenteve nga stafi akademik per te vizituar biblioteken e Universitetit per tu hequr emocionet...</i>
<i>Te shtohen libra ne bibliotek pasi nuk ka asnje liber ne baze te lendeve universitare sidomos ne shkenca kompjuterike</i>	<i>Po i drejtohem bibliotekes ne godinen C. Shpesh here nuk ka personel ne biblioteke gjate oreve aktive te bibliotekes, e gjejme deren te kycur per disa ore, madje tere ditën.</i>
<i>Ne nuk kemi nje informacion se ekziston nje biblioteke online ne universitet. (7 studentë)</i>	<i>Nuk me ka rene rasti ta frekuentojë, nuk me ka lidhur puna deri tani!</i>
<i>Nuk ekziston nje biblioteke shkollore tek universiteti i shendetit (2 studentë)</i>	<i>Te shtohen librat ne ndihme te studenteve (2 studentë)</i>
<i>Pa pergjigje (7 studentë)</i>	<i>Nuk ka nevojë per permiresim (4 studentë)</i>
<i>Me shume materiale lidhur me delet e U.V</i>	<i>Komunikimin dhe korrektesin e pedagoqeve</i>
<i>Katalogun e bibliotekës, duhet përditësuar</i>	<i>Informacione me te detajuara lidhur me funksionimin</i>
<i>Shpejtesine e faqes online</i>	<i>Te kemi nje biblioteke bashkekohore (5 studentë)</i>




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

II.A.5- Laboratorët /Qendrat Kërkimore Shkencore, pranë Fakulteteve:

Në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë pranë çdo njësie kryesore janë ngritur qendrat kërkimore shkencore, si dhe njëkohësisht në funksion të procesit mësimor janë ngritur laboratorët didaktik/mësimor. Nëpërmjet 4 (katër) pyetjeve të mbyllura studentët janë përgjigjur mbi shpeshtinë e frekuentimit të laboratorëve si dhe kanë vlerësuar disa aspekte si respektimin e etikës së komunikimit, mjaftueshmërinë ose jo të pajisjeve laboratorike si dhe shfrytëzimin e këtyre strukturave për të realizuar punën e tyre kërkimore të pavarur.

Pyetjes se sa shpesh i kanë frekuentuar QKSH studentët, jepet përgjigjur si vijon: 29.3% e studentëve gjithmonë, 18.7% shpeshherë, 12.2% rrallëherë, 14.4% pa përgjigje dhe 25.4% asnjëherë, një përqindje kjo relativisht e lartë, e treguar dhe në grafikun nr. 18:

Grafiku 18: " Sa shpesh i keni frekuentuar Qendrat Kërkimore Shkencore ?"




Në lidhje me respektimin e etikës prej personelit 45.1% e përgjigjeve janë shprehur se është respektuar gjithmonë, 16.7% janë shprehur shpeshherë, për 4.7% rrallëherë, 6.1% të studentëve asnjëherë si dhe vetëm 27.4% e tyre pa përgjigje.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 19: "A komunikon me ju personeli duke respektuar etikën e komunikimit?"



Përsa i përket pyetjes nëse pajisjet laboratorike janë të mjaftueshme për realizimin e orës mësimore 24.2% e studentëve i konsiderojnë të mjaftueshme pajisjet në laborator dhe 31.7% mëse të mjaftueshme, dhe studentët që e kanë lënë pa përgjigje rreth 27.6% dhe respektivisht 10.2% të studentëve janë përgjigjur aspak të mjaftueshme si dhe për 6.3% të studentëve janë përgjigjur se nuk janë bashkëkohore. Grafiku si vijon:

Grafiku 20: "A gjykoni se pajisjet laboratorike janë të mjaftueshme për realizimin e orës mësimore?"






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Së fundmi, në lidhje me shpeshinë e përdorimit të QKSH/Laboratorët për punë të pavarur kërkimore të anketuarit identifikuan sipas grafikut të mëposhtëm se 28.7% i frekuentonin gjithmonë, 18.5% shpeshherë, 13.2% rrallëherë, 23.6% pa përgjigje dhe 16.1% asnjëherë. Si shihet në grafikun Nr. 21:

Grafiku 21: "Sa shpesh i përdorni QKSH/Laboratorët për punë të pavarur kërkimore?"



Qëndrimet e studentëve në pyetjet e mbyllura theksohet më tepër edhe në përgjigjet e tyre në pyetjen e hapur: **“Ju lutem propozoni se cfarë do të dëshironit të përmirësoni?”**, të cilës i janë përgjigjur **357** studentë nga ku **148** prej tyre mendojnë se nuk kanë asgjë për të përmirësuar. Mendimet e tjera ishin të shumta si: pasurimi i laboratorëve me mjete të reja, praktikat bashkëkohore dhe më të shpeshta, shtimi i numrit të qendrave dhe laboratorëve, etj (për më tepër referojuni komenteve të hollësishme në Tabelën 8:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 8: Komentet e studentëve- Qendrat Kërkimore Shkencore/Laboratorët

Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (357 përgjigje)	
<i>Asgje (148 studentë)</i>	<i>Se di/ nuk kam (12 studentë)</i>
<i>Fondet duhen drejtuar perkundrejt ketyre laboratoreve</i>	<i>Personeli i papershtatshe me vendin e punes</i>
<i>Sa me shume materiale dhe mjete ne ndihme te studentit.</i>	<i>Ne degen time nuk ben pjes laboratorit (5 studentë)</i>
<i>Pa përgjigje/Nuk kam mendim (13 studentë)</i>	<i>Duhet te kete permirsime shume ne infrastrukture</i>
<i>Gjithcka eshte ne rregull (24 studentë)</i>	<i>Sa m shume kompjutera funksional (4 studentë)</i>
<i>Pajisjet mesimore te shtohen ne perputhje me nevojat e cdo lende.</i>	<i>Nuk kam Propozim (10 propozime)</i>
<i>Tabelat teknologjike me info do ishte mire te ishin ne hyrje te Universitetit por edhe ne cdo kat ku te azhornoheshin info ne lidhje me programet, etj.</i>	<i>Neve si Student Akuakultre bëjme rregullisht mesime Laboratorike si Auditor në grup! Keshtu e kemi programin! Deri tani jemi shumë të kënaqur! Te vazhdohet keshtu!</i>
<i>Nje organizim me i mire ne pershirjen dhe orientimin e studenteve ne keto qendra</i>	<i>Te jenë te gjitha materialet e nevojshme dhe bashkekohore (23 studentë)</i>
<i>Info te perditesuara ne tabele elektronike ne lidhje me gjithcka qe ka lidhje me universitetin.</i>	<i>Sa me shume qendra kerkimore (4 studentë)</i>
<i>Zero</i>	<i>Hapesira me te medha ku te veprojme</i>
<i>Nuk kam info (2 studentë)</i>	<i>Noten (2 studentë)</i>
<i>Vini ne sherbim te studentit pajisjet dhe produktet e duhura kimike per zhvillimin efektiv te ores laboratorit.</i>	<i>Te shtohen baz materialet per kryerjen e ores se laboratoreve</i>
<i>te marim me shum pjes ne qendrat kerkimore shkencore (5 studentë)</i>	<i>Shpenzimet e praktikes te kryen nga shkolla</i>
<i>A ka qendra të kerkimit shkencor?! (3 studentë)</i>	<i>Me shume perfshirese (2 studentë)</i>




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

II.A.6 - Sektori i IT-së:

Seksioni P.1 f- se si e vlerësojnë platformën online të universitetit (UVMS), e shohim të paraqitur në Grafiku 22: " Si e vlerësoni platformën online të Universitetit (UVMS)?", ku qartasi duket se 51.6% e studentëve janë shprehur shumë të mirë, 33.1% të mirë, 9.6% pa përgjigje, 2.8% keq si dhe po aq shumë keq 2.8%. Grafiku 22 si vijon:

Grafiku 22: " Si e vlerësoni platformën online të Universitetit (UVMS)?"




Faqja e web-it të UV-së është kanali më i rëndësishëm i shpërndarjes së informacionit, prandaj në këtë pjesë të pyetësorit përdoruesit kanë shprehur opinionin mbi përdorimin e tyre të faqes, kënaqësinë me përmbajtjen, veçoritë teknike të faqes, bazat e të dhënave dhe paraqitjen e sugjerimet e tyre për përmirësime.

Në këtë seksion studentët shprehin se shërbimet online që ofrohen në faqen zyrtare të internetit të UV-së janë 45.5% më se të mjaftueshëm, janë të mjaftueshme shërbimet për 25.2% të studentëve që kanë plotësuar pyetësorin, 17.7% deri diku, për 8.9% e studentëve kanë përzgjedhur alternativën pa përgjigje si dhe 2.6% e konsiderojnë aspak të mjaftueshëm. Në vijim ndodhet grafiku 23:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 23: "A gjykoni se janë të mjaftueshme shërbimet online për studentët që ofrohen në faqen zyrtare të internetit të UV-së?"



Pyetja e tretë e seksionit i përket nëse gjendet lehtë informacioni i kërkuar në web-in e UV-së, dhe 48.6% e studentëve janë shprehur gjithmonë, 30.1% shpeshherë, 9.1% rrallëherë, 3.5% asnjëherë dhe 8.7% pa përgjigje. Falë zhvillimit të jashtëzakonshëm të internetit, medias sociale, të telefonisë mobile dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në tërësi, edhe faqja e web-it të UV-së është e aksesueshme dhe e lehtë në përdorim. Në *grafikun 24* gjenden përgjigjet:

Grafiku 24: "A e gjeni lehtësisht informacionin e kërkuar në web-in e UV-së?"





REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 9: Komentet e studentëve- Shërbimet Teknologjike/IT: i përket komenteve të studentëve se çfarë do të dëshironin të përmirësonin tek shërbimet teknologjike/IT. Nga 492 studentë që kanë marrë pjesë në pyetësor, në këtë seksion janë përgjigjur 358, ku një pjesë e mirë e studentëve respektivisht 163 prej tyre janë shprehur asgjë për përmirësim, ndërsa problematikat më të shpeshta janë informacioni i paktë dhe i pa përditësuar, vështirësitë në akses, probleme në sistemin e UVMS I azhurnuar, shtim i shërbimeve online, njoftime të pasakta.

Tabela 9: Komentet e studentëve- Shërbimet Teknologjike/IT

Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (358 përgjigje)	
<i>Asgje (163 studentë)</i>	<i>Se di (16 studentë)</i>
<i>Lëndët të rregjistrohen automatikisht për studentët që permbushin kriteret sepse shpesh kemi pas probleme me nr e krediteve nuk na lejon sistemi te rregjistrohemi ne te gjitha lendet dhe sjemi fut ne provim.</i>	<i>"1. Sektori i njoftimeve - studentët nuk marrin njoftime kur vlerësohen me notë nga pedagogët 2. Mos-shfaqja e lëndëve pa plotësimin e anketimit për pedagogët dhe lëndën që ata japin. Mendoj se anketimi duhet të jetë opsional, jo i detyrueshëm për të shfaqur lëndët dhe vlerësimet."</i>
<i>Te perditesohen infot ne lidhje universitetin (2 studentë)</i>	<i>Eshte ne rregull (33 studentë)</i>
<i>Perditesimi i faqes ne menyre periodike dhe afishimin e cdo vendimi te SA BA dhe Rektorati ne kohe, jo pas 6 muajsh prsh</i>	<i>Me lehte i aksesueshem per te marr informacione rreth cdo gje te universiteteit. Duke perfshir dhe e-maile te pedagogve.</i>
<i>Mire do ishte te kishte nje info me te strukturuar ne lidhje me klikimet sepse duket sikur ka shume propozime por jo mire te klasifikuara, te strukturuar</i>	<i>Mos te kishim pengesa me pyetesor per te pare vlersumet e marra per lendet perkatese</i>
<i>Oraret e provimeve te afishohen ne faqet individuale sipas fakultetev ne inbox</i>	<i>Te ishte pak me i sofistikuar ae tani dje te ofroheshin me teper sherbime</i>
<i>Shume mire, pa verejtje (2 studentë)</i>	<i>Nuk kam propozim (13 studentë)</i>
<i>Sherbimi eshte i kenaqshem, te vazhdoi me keto ritme.</i>	<i>Ne moment kur kemi provime ose data te shenohen tek informacionet ne portal</i>




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Te kete nje sistem pak me te ri ne menyre te tille qe sistemi mos te fiket si ndodh shpesh here</i>	<i>Mendoj duhet te kete dhe sherbimin e notes mesatare te perfshire</i>
<i>Hapa para dhe universiteteve të Tiranës</i>	<i>Hedhjen e pikëve ne kohe reale</i>
<i>Risi në fusha komunikimi (2 studentë)</i>	<i>Cilesi sherbimi (8 studentë)</i>
<i>Pak me shum informacion rreth notave (4 studentë)</i>	<i>Informacion me i detajuar dhe i shpejt (13 studentë)</i>

II.A.7- Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve Jashtë:

Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve Jashtë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij një prej aktiviteteve konsiston në organizimin e aktiviteteve të ndryshme me qëllim promovimin e ndërkombëtarizimit të UV-së. Marrë në konsideratë kjo, pyetja: “A keni marrë pjesë na aktivitetet e organizuara nga SPMJ?”, ka për qëllim vlerësimin e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete për të ndërmarrë më tej veprimtari që do të përmirësojnë rezultatet nëse është e nevojshme. Pasqyruar edhe në Grafikon 25 një përqindje e konsiderueshme e studentëve 23.8% e studentëve janë shprehur asnjëherë si dhe 12.6% rrallëherë. Ndërkohë që 27.4% janë shprehur se gjithmonë kanë qënë pjesë e aktiviteteve të organizuara nga SPMJ si dhe 20.1% shpeshherë, 16.1% pa përgjigje.

Grafiku 25: "A keni marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga SPMJ?"






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Në pyetjen sesi do t'i vlerësonit aktivitetet e SPMJ, nga 492 studentë që kanë plotësuar pyetësorin, kësaj pyetje i janë përgjigjur po **492** prej tyre, ku 41.1% e vlerësojnë shumë të mirë, 25.4% mirë, vetëm 6 studentë (1.2%) e kanë vlerësuar shumë keq, dhe 3% e kanë konsideruar të keq. Grafiku 26 tregon më qartë përgjigjet e studentëve:

Grafiku 26: "Në përgjithësi si do ti vlerësonit aktivitetet?"




Pyetjes se a komunikon personeli duke respektuar etikën e komunikimit. Nga rreth 492 studentë të cilët kanë përzgjedhur në pyetjen e mësipërme një prej alternativave gjithmonë, shpeshherë, rrallëherë, 47.8% e tyre janë përgjigjur se personeli e respekton gjithmonë etikën, për 17.7% të studentëve shpeshherë, për 5.1% rrallëherë, 12 studentë (2.4%) kanë përzgjedhur alternativën asnjëherë, si dhe 27% e studentëve janë shprehur pa përgjigje. Përgjigjet paraqiten hollësisht në Grafikon 27:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 27: " A komunikon me ju personeli duke respektuar etikën e komunikimit?"



Përsa i përket vlerësimit nëse aktivitetet që organizon ky sektor janë të mjaftueshëm, rezultojnë se rreth 35.4% e tyre mendojnë se aktivitetet janë më se të mjaftueshme, 21.7% të mjaftueshme, 13% deri diku, 4.3% të pamjaftueshëm si dhe 25.6% e kanë përzgjedhur alternativën pa përgjigje. Grafiku i mëposhtëm si vijon:

Grafiku 28: " A gjykoni se janë të mjaftueshëm aktivitetet e organizuara nga SPMJ?"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Në *Tabelën 10* janë paraqitur përgjigjet e studentëve se çfarë do të propozonin për përmirësim. Rreth gjysma e studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor, **350** studentë kanë plotësuar këtë pyetje duke shprehur mendimet e tyre. Duke iu referuar kësaj table, **152** studentë kanë thënë *asgjë* për përmirësim, ndërsa një pjesë e mirëfilltë kanë dhënë idenë se aktivitetet në këtë sektor duhet të rriten dhe studentët të kenë mundësi më të shumta informimi. Këto të dhëna forcohen edhe më tej nga rezultatet e përgjigjeve të studentëve në pyetjet e mësipërme të mbyllura.

Tabela 10: Komentet e studentëve- Sektori i Projekteve

Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (350 përgjigje)
<i>Cdo gje qe eshte e nevojshme ne kete drejtim per t'u permiresuar.</i>
<i>Asgje (152 studentë)</i>
<i>Mendoj se ka goxha permiresime nga viti ne vit</i>
<i>me shume aktivitet dhe pjesemarje te studenteve (13 studentë)</i>
<i>Pa përgjigje (9 studentë)</i>
<i>Nuk e di (20 studentë)</i>
<i>Cdo gje ne rregull (22 studentë)</i>
<i>Te ketë efikasitetin e duhur punësimi i Studentëve nga projektet që propozojnë Biznesmenët, që organizojnë mbledhje publike, me qëllim shpalosjen e kërkesave për fuqi punëtore nga rradhët e Studentëve!</i>
<i>Perfshirja sa me teper e studenteve, dhe mireinformimi i tyre rreth ketij sektori.</i>
<i>Nese do behen me teper aktivite me pozitive jane per studentet.</i>
<i>Nuk kam sugjerime (14 studentë)</i>
<i>Nuk kemi marre asnjehere pjese ne aktivite nga sektori i projekteve per arsye se nuk jemi njoftuar.</i>
<i>Nese ka raste qe vijne studente nga treva te tjera shqiptare apo nga shtete te tjera te kishte nje prezantim, shkembime kulturele etj.</i>
<i>Jane shume te respektushme dhe te komunikushme (3 studentë)</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Cilesi sherbimi (3 studentë)</i>
<i>Te kishim me shume organizime aktivitetetesh me shtetet e tjera.</i>
<i>Etike ne veshje, urtesi, butesi...</i>
<i>Sa me shume projekte (3 studentë)</i>
<i>aktivitetetet duhet te synojne cilesine dhe jo sasine, thjesht per statistike.</i>
<i>Me shume marredhenie me jashte</i>
<i>Organizim me gjithepershirje (2 studentë)</i>
<i>Me shume sensibilizim</i>
<i>Nuk kam mar pjese (5 studentë)</i>
<i>Të tjera (10 studentë)</i>

II.B- SEKSIONI I DYTË

Në këtë seksion studentët nëpërmjet 6 (gjashtë) pyetjeve të mbyllura dhe 1 (një) të hapur, kanë vlerësuar infrastrukturën dhe kushtet higjenosanitare duke përfshirë disa dimensione si mjediset e auditorëve, sistemin e ngrohjes, sistemin e ndriçimit, cilësinë e bazës materiale, higjena e auditorëve, higjena e tualeteve etj. Në *Tabelën 11* të mëposhtme janë paraqitur rezultatet për secilin prej aspekteve të vlerësuara të shprehura në përqindje.




REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Tabela 11: Rezultatet mbi Vlerësimin e Infrastrukturës

	<u>Shumë Mirë</u>	<u>Mirë</u>	<u>Keq</u>	<u>Shumë Keq</u>	<u>Pa përgjigje</u>
Mjediset e auditorëve	44.3%	42.07%	9.14%	3.65%	0.81%
Cilësia e bazës materiale (tavolina, karrige,projektor, whiteboard, etj)	42.02%	44.51%	9.14%	3.25%	1.01%
Sistemi i ngrohjes/ftohjes	36.58%	30.08%	23.57%	8.53%	1.21%
Sistemi i ndricimit	42.07%	44.51%	9.14%	3.86%	0.4%
Higjena e tualeteve	38%	33.53%	16.86%	9.75%	1.82%
Higjena e auditoreve	43.49%	42.68%	9.34%	3.45%	1.01%

Sikurse mund të evidentohet edhe prej grafikut të mëposhtëm, dimensionin më keq i vlerësuar prej studentëve është sistemi ngrohjes/ftohjes, I ndriçimit, cilësia e bazës materiale si dhe higjena e tualeteve.

Grafiku 29: “ Si do ta vlerësonit infrastrukturën dhe kushtet higjeno-sanitare”



Në bazë të rezultateve në pyetjen e hapur, megjithëse pjesëmarrja është e ulët, 492 studentë, në përgjigjet e tyre ata shprehin një interes të konsiderueshëm për të përmirësuar më tej kushtet higjeno-sanitare dhe insfrastukturën në UV. Duke analizuar komentet e studentëve problematika kryesore e tyre është:



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

- higjena e tualeteve
- sistemi i ngrohjes në auditore
- mungesë infrastrukture
- cilësia e bazës materiale (karrige e tavolina)
- ndriçimi
- përmirësimi i kushteve të klasave

Kjo shihet qartë tek Tabela 12 e paraqitur më poshtë:

Tabela 12: Komentet e studentëve – infrastruktura dhe kushtet higjeno-sanitare

<i>Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (366 përgjigje)</i>		
<i>Asgje (137 studentë)</i>	<i>Higjiene me e pastër e wc, te gjitha mjetet e nevojshme per ne laborator, komunikimi i sekretareve me studentet te jetë më i qarte dhe jo te na flasin ne cdo rast me nje gjuhe urrejtjeje</i>	
<i>Higjeren dhe kushtet e tualeteve (29 studentë)</i>	<i>Ambientetet ku zhvillohen leksionet (pra nje godine fakulteti e mirfillte)</i>	<i>Sistemin e ngrohjes dhe t ftohjes (15 studentë)</i>
<i>Auditor i ri per studentet e infermierise dhe kushte me te mira per te studiuar</i>	<i>Pastertine dhe kujdesi ndaj higjenes si ne klasa ashtu dhe ne tualete.</i>	<i>Te vendosen letra higjenike ne ambjentet e tualeteve dhe dyert t'ju mundesohet mbyllja.</i>
<i>Godine te mirefillte, pa shtylla ne mes te auditoreve qe na pengojne te ndjekim me sy leksionet.</i>	<i>"Tualetet jane nje skandal i vertet, ere qe kuterbon gjithandej, mungon klori mungojn letrat higjenike,</i>	<i>Kondicionere (5 studentë)</i>
<i>Te invenstohet me shume ne infrastukturen brenda universitetit.</i>	<i>Me teper pergjegjesi mbi kushtet dhe mbajtjen e nje higjene te perhershme.</i>	<i>Hapsire te pershtatshme per nje fakultet sic eshte ai i Shendetit (2 studentë)</i>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Nuk kam/Se di (7 studentë)</i>	<i>Te gjitha (13 studentë)</i>	<i>Cdo gje eshte ne rregull (9 studentë)</i>
<i>Nuk kam propozim (10 studentë)</i>	<i>Me shume pastrime ne salla dhe laboratore</i>	<i>Shume mire/mire (3 studentë)</i>
<i>Duhet infrastrukture e re (6 studentë)</i>	<i>Cilesia e bazes materiale (2 studentë)</i>	<i>Laboraret (2 studentë)</i>
<i>Tualet dhe ambjentet brenda klasave te higjienizohen me shpesh. Gjithashtu dhe kondicionimim me ajer te ftohte dhe te ngrohte ne cdo klase.</i>	<i>Pastrimi i tualeteve eshte ne nivele te uleta. Do te doja qe te kishte me teper higjene, me teper detergjente, me teper mirembajtje.</i>	<i>Njoha vlere - karaktere - bote- kulture dhe sigurisht kam se cfare te marre prej tyre; edhe pse ne kete moshe qe jam.</i>
<i>Te rinovohen klasat mesimore, me karrike me te pershtatshme per mesim. Te rinovohen toaletet dhe te kete qasje ne toalete gjate gjithes dites (te mos mbyllen toaletet qe jane per student).</i>	<i>Godine e pershtatshme dhe dinjitoze eshte urgjente!!! Eshte nje detyrim njerezor/ human ndaj brezit qe edukohet si edhe per stafin akademik qe eshte cdo dite perdorurues njelloj, i ketyre ambjenteve! Eshte nje MUST!</i>	<i>Ne menyre qe edhe kushtet higjieno- sanitare te jene te dukshme dhe te perfitohet nga te gjithesherbimi i pastrimit dhe akomodimit nga stafi i pastrimit/ mirembajtjes, se Fakultetit</i>
<i>Projektoret as qe ekzistojn, whiteboard jemi ende me dërrasë të zezë dhe më kryesorja skemi as kushtet minimale per zhvillimin e leksioneve per sa I perket sistemit te ngrohjes dhe ftohjes</i>	<i>Nuk eshte eshte mire qe pastrueset(sanitare) te pastrojne ne momentet qe ka studente ne auditore, koridore.</i>	<i>Të rritet kujdesi i studentëve ndaj këtyre mjeteve. Mos të ngjisin më çimçakiza poshtë tavolinave dhe mos të shkruhen.</i>
<i>Pajisjet shkollore bankat, tabelat etj</i>	<i>Kushte më të mira (6 studentë)</i>	<i>Noten (3 studentë)</i>
<i>"Te pastrohen me shpejt, tu mesohet teknika se si te pastrojne etj;</i>	<i>Te rregullohen dritaret (2 studentë)</i>	<i>Ambjentin mesimor, laboraret dhe klasat e leksionit (2 studentë)</i>
<i>Te gjitha të rregullohen se është turpi i Universitetit</i>	<i>Disa klase jane shume te nxeta kur bie dielli</i>	<i>Audoret te kene me teper hapësire (2 studentë)</i>
<i>Komoditeti I sallave të leksioneve</i>	<i>Te kishte tualete me te mira sepse nuk kane asnje kusht higjeno sanitar</i>	<i>Te shtohet higjiena ne tualete dhe auditore (3 studentë)</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Gjithashtu edhe per sigurine ndaj njeriut, te tilla si :1. Ndaj njerezve me probleme shendetesore mendore2. Ndaj njerezve me prirje terroriste.3. Ndaj kafsheve te rruges.(1,2,3, - renditen se bashku pasi ne ambjentet egzistuese mundesia e perballjes me kete lloj rreziku eshte ne perqindjen maksimsle(kjo sipas mendimit tim)4. Ndaj perballjws me nje fatkeqesi te mundshme natyrore - sistemike- njerezore, si : termet, permytje nga rrjeti i ujit, renie e nje pjese te struktures se tavanit apo te dyshemese, zjarri nga mase ne sistemin elektrik ose nda zjarrevenue e pakujdesshme. Ndjese per sa me lart, por meqe m'u dha mundesia te kem-ta shfaq dhe ta jap nje mendim; ja u kam renditur cfare mendoj dhe se si do te doja te pakten minimalisht apo normalisht te funksiononte nga ana strukturore nje godine Universitare.

"Gjithcka: ambjente te perstatshme per qellimin qe perdoren- shkollimin/ studimin. Qeniet humane (pedagoge + studente) meritojne te kene minimumin e kushteve te jeteses/ qendrimit. Staf i shkelqyer akademik, fakultet interesant + intensiv; ne kushte mjerane, absolutisht te papershtatshme, sidomos nga ana e sigurise per jeten (sociale edhe/apo strukturale). Hyn i krisuri/ hyn qeni/ bie copa e tavanit ne koken e studentit dhe natyrisht hyjne profesoret dhe studentet- mendoni se sa hyn "dija" dhe "te nxenit" ne gjithe kete. E kenaqur absolutisht dhe e lumtur qe jam pjese e ketij fakulteti, edhe pse moshja eshte pak jo e njejte me masen studentore; kenaqesia me e madhe eshte qe njoha pedagoge / profesore/ dktore / dhe lektore kaq te njerezishem/ te cilter/ pa tabu/ pa vendosur kufij ndalues midis nesh. Faleminderit."

Ndjese per komentin jashtezakonisht te gjate.

Nuk do te doja qe femija im te studionte cdo dite duke pare/ prekur/ jetuar ne keto ambjente. Jo per pastertime, sepse zonjat e pastrimit e kryejne me korrekte pune e tyre, por eshte vete struktura/ ndertesa/funksionalizmi i saj qe te ofron mjerim/ trishtim dhe te heq deshiren te jesh aty prezent.

"Gjithcka: ambjente/auditore te mirefilta, te duhurat nga ana e konstruktit por edhe laboratoreve/sherbimeve/strukturave ne sherbim te mesim dhenies-nxenies, ambjente te pershtatshme per qendrimin e studenteve gjate kohes ne fakultet dhe kushte te pershtatshme (tualetet te pershtatshme dhe dinjitoze, sistem funksional ngrohjes/ftohes),

Te gjitha kushtet jane skandaloze	Te gjitha kane nevojte per permirsim	Çdo gjë që të ketë cilësi adekuate.
Sherbimi me efikas duhet te jete	Teknologji me te avancuar	Ambjentin e shkolles
Çdo gje minimale	Karriget	Infrastrukturen kushtet ne auditore
Zero	Shume gjera	Leksion




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

II.C- SEKSIONI I TRETË

Së fundi ky seksion ka për qëllim marrjen e të dhënave mbi përfshirjen e studentëve në aktivitete të ndryshme që organizon UV-ja si: shërbime komunitare, punë vullnetare, projekte kërkimore, aktivitete shkencore, etj. Njëkohësisht identifikimi i rrugëve të komunikimit nëpërmjet të cilave studentët do të dëshironin të informoheshin mbi aktivitetet në UV ndihmon në forcimin e lidhjeve dhe urave të komunikimit midis institucionit dhe studentëve.

Në pyetjen: "A keni marrë pjesë në punë vullnetare ose shërbime komunitare të organizuara prej UV-së gjatë vitit akademik?" – 24.8% e studentëve janë përgjigjur gjithmonë, 14.4% shpeshherë, 17.1% rrallëherë, 15.9% pa përgjigje si dhe një përqindje e konsiderueshme e studentëve, 27.8% janë shprehur se nuk kanë qënë pjesë asnjëherë e shërbimeve komunitare të organizuara prej Universitetit gjatë vitit akademik 2023-2024. Për më tepër grafiku:

Grafiku 30: "A keni marrë pjesë në punë vullnetare ose shërbime komunitare të organizuara prej UV-së gjatë vitit akademik?"




Pyetjes: "A keni marrë pjesë në projekte kërkimore, aktivitete shkencore të organizuara prej Universitetit gjatë vitit akademik?" – 26.2% e studentëve janë shprehur se gjithmonë kanë marrë pjesë në aktivitete shkencore të organizuara, 18.1% janë përgjigjur respektivisht shpeshherë dhe 18.3% rrallëherë, 15.9% pa përgjigje dhe 21.5% e studentëve që janë përgjigjur pyetësorit kanë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

shprehur se asnjëherë s'kanë qenë pjesë e aktiviteteve shkencore ose projekteve kërkimore të organizuara nga UV-ja gjatë vitit akademik. Paraqitja grafike jepet si më poshtë vijon:

Grafiku 31: "A keni marrë pjesë në projekte kërkimore, aktivitete shkencore të organizuara prej UV-së gjatë vitit akademik?"




Pyetjes nëse do të dëshironin të ishin të informuar mbi aktivitetet e ndryshme që organizon Universiteti si (konferenca, trajnime, intership, praktika pune, etj), 53.3% e tyre thanë gjithmonë, 24.6% po në varësi të tipit të aktivitetit, 9.8% rrallëherë, 1.6% asnjëherë dhe 10.8% e tyre pa përgjigje. *Grafiku 32* pasqyron përqindjen e studentëve:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 32: "A do të dëshironit të ishit të nformuar mbi aktivitete që organizon UV-ja??"




Për Universitetin e Vlorës ruajtja e marrëdhënieve me studentët është thelbësore. Me qëllim gjetjen e mënyrës më të mirë për të komunikuar me studentët, këtyre të fundit ju drejtuan dy pyetjet që vijojnë:

- ✓ Pyetja 3.c. 1 se si do të dëshironin të informoheshin, i janë përgjigjur 487 studentë ku 40.5% dhanë përgjigje nëpërmjet e-mail-it dhe 35.1% përzgjedhën faqen e internetit, 6.2% nëpërmjet rrjetit social facebook, 11.9% materiale informuese, stenda fletëpalosje, postera, 3.7% fjalë pas fjale dhe 2.7% tjetër. Grafiku 33 si më poshtë vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Grafiku 33: "Si do të dëshironit të informoheshit, nëpërmjet:"



Në Tabelën 13 jepen të dhënat mbi pyetjen e hapur të studentëve të cilët në pyetjen e mësipërme kanë përzgjedhur alternativën tjetër.

Megjithëse përgjigjet e studentëve nuk përputheshin me pyetjen, përsëri ata kanë shprehur opinion se ka vend për përmirësim në të gjitha hapësirat e institucionit si cilësinë, shërbimin ndaj studentëve, komunikimin e sekretarive etj. I janë përgjigjur **255** studentë nga **492** të cilët kanë marrë pjesë në pyetësor. Tabela si më poshtë vijon:

Tabela 13: Komentet e studentëve – shërbimet komunitare dhe vullnetare

(Tjetër )

<i>Ju lutem propozoni se çfarë do të dëshironit të përmirësonit? (255 përgjigje)</i>	
<i>Asgje (102 studentë)</i>	<i>Nuk kam/ Se di (15 studentë)</i>
<i>Nuk kam sugjerime (5 studentë)</i>	<i>Më shumë angazhimi</i>
<i>Te informohem dhe nga pergjes te universitetit</i>	<i>I rëndësishëm është lloji i aktivitetit jo informimi</i>
<i>Nepermjet e-mailit,facebook,afishimeve te infove ne hyrje,koridore...etj: (2 studentë)</i>	<i>Shpresojme qe pergjigjet tona te marren parasysh.</i>
<i>Informacione ne fakultet</i>	<i>Me njoftime ne faqen e universitetit (5 studentë)</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

<i>Shume mire/ Te gjitha (3 studentë)</i>	<i>Permiresimi i sherbimeve komunitare</i>
<i>Cdo gje eshte ne rregull (7 studentë)</i>	<i>Instagram/facebook (5 studentë)</i>
<i>Me email ose ndonje fletepalosje</i>	<i>Informacion nepermjet sekretareve dhe posterave</i>
<i>Çdo gjë në nivelin e duhur</i>	<i>Nëpërmjet Stafit Akademik.</i>
<i>Email dhe fjale per fjale (7 studentë)</i>	<i>Fletepalosje (2 studentë)</i>
<i>Pa pergjigje</i>	<i>Whatsapp/sms (4 studentë)</i>
<i>Sekretarive (2 studentë)</i>	<i>Jo jane mjaftueshem keto</i>
<i>Mjafton</i>	<i>Cfaredo lloj</i>
<i>Te kishte me shum aktivitete</i>	<i>Ne auditor</i>
<i>Zero</i>	<i>Me leksione</i>
<i>Pa Koment</i>	<i>Punime nga ne</i>
<i>Te informohemi nje dite para aktivitetit, sepse ne faqen e univlora artikulli shkruhet pasi eshte bere aktiviteti.</i>	
<i>Te gjitha menytrat, pavaresisht se une personalisht nuk jam perdoruese e rrjeteve sociale. (facebook etj)</i>	
<i>Te kemi me shume aktivitete ku te bashkeveprojm me grupe studentesh qofte kerkime shkencore ose projekte te ndryshme</i>	
<i>Deshiroj te informohem rreth konferencave qe zhvillohen ne vlore, specifikisht ne universitet.</i>	

Në përfundim, raporti i Pyetësorit për shërbimet ndihmës akademike dhe administrative të ofruara për vitin akademik 2023-2024 i përgatitur dhe i strukturuar sipas çështjeve dhe fushave të kërkuara, synon të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së UV-së në zbatim të misionit dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Pas shqyrtimit të përgjigjeve të studentëve të programeve të Ciklit të Parë, të Dytë dhe Ciklit të Tretë të studimeve në këtë pyetësor dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, duke parë që një përqindje shumë e vogël e studentëve e kanë plotësuar, ne më poshtë po përmbledhim problematikat më të shpeshta të syjeruara nga studentët:

- ❖ *Pasurimi i Bibliotekës me libra bashkëkohorë*
- ❖ *Sistemi i ngrohjes/ftohjes, Ambjente të pastra dhe me ndriçim të mjaftueshëm për auditorët*
- ❖ *S'ka organizim faqja e universitetit, Ndërfaqe grafike, Të jetë më i strukturuar*
- ❖ *Kushtet e laboratorëve dhe pajisjet të jenë funksionale*
- ❖ *Më shumë aktivitete për njohjen e shërbimeve që ofrohen nga UV-ja.*
- ❖ *Shpejtësinë e dhënies së i informacioneve dhe saktësinë*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE
NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Pas përfundimit të procedurës për sigurimin e brendshëm të cilësisë, u hartua pyetësori përmbledhës, i cili bëhet publik në web-in e UV-së. Raporti është një përmbledhje e fakteve dhe interpretimit të tyre. Me qëllim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve ndihmës akademike dhe administrative në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë është përdorur metodologjia sasiore dhe instrumenti për vjeljen e të dhënave nga pyetësori për analizën e informacionit. Përmirësimi i një sistemi efektiv të manaxhimit të integritetit në institucion, që synon sigurimin e respektimit të kërkesave ligjore, proceduriale, si dhe kuadrit të brendshëm rregullator.

UV-ja ka mekanizmat e saj për matjen e cilësisë, procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitetin "Ismail Qemali", e cila ka një rol të veçantë në këto zhvillime dhe është organi kryesor brenda UV për matjen e cilësisë së brendshme.

I gjithë procesi, i hartimit të pyetësorëve, lancimit të tyre dhe i mbledhjes së të dhënave është bërë nga NJSBCVI-ja. Procesi është transparent, dhe të gjithë pyetësorët janë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit studentë dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

Ky studim përqëndrohet në lloje të ndryshme të temave të tilla si: preferenca, sjellja, etika, ose informacione faktike në varësi të qëllimit të tij.

Ngaqë hulumtimi i pyetësorit është gjithmonë i bazuar tek studentët, sukcesi i këtij hulumtimi varet nga përfaqësimi i kampionit në lidhje me interesin e shfaqur në pyetësor. Metodologjia e anketës si një fushë shkencore kërkon të identifikojë parimet në lidhje me instrumentat e grumbullimit të të dhënave, rregullimin statistikorë, përpunimin e të dhënave, si dhe analizën përfundimtare e të dhënave që mund të krijojë gabime të anketimit sistematike dhe rastësore.